



QENDRA ISLAMIKE KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI
ALBANSK ISLAMSK KULTURSENTER I NORGE
ALBANIAN ISLAMIC CULTURAL CENTER IN NORWAY

Oslo, 10. Janar 2026

Njoftim për aktivitetet gjatë muajit Ramazan 1447H/2026

Shprehim nderin që të gjithë besimtarëve të fesë islame dhe anëtarëve të QIKSHN'së t'ju urojmë muajin e Kur'anit dhe muajin e agjërimit dhe lutim Zotin të na e pranoj agjërimit.

QIKSHN ju njohfton se gjatë muajit të Ramazanit orari i ligjëratave dhe namazeve do të jetë me sa vijon :

1. Teravia e parë do të falet në ora 19:11 min me datën 18. Shkurt 2026, dita e Mërkurë.
2. Fillimi i agjërimit do të jetë në ora 05:30, dita e Enjte, më datën 19. Februar 2026. Pra përfundimi i syfyrit dhe fillimi agjërimit.
3. Para çdo namazi të drekës dhe ikindis – Lexim Kur'ani & Mukabele nga ndihmës imami.
4. Para çdo namazi të teravis do të ketë ligjëratë të shkurtë nga Dr. Berat Hashani dhe ndihmës imami.
5. Më 28. Shkurt 2026, dita e Shtunë – Iftar të përbashkët për gratë.
6. Më 07. Mars 2026, dita e Shtunë – Tribunë Fetare dhe Iftar të përbashkët për burat – Ligjërues mysafiri special nga vendlindja.
7. Më 07. Mars 2026, dita e Shtunë ose më 17 Ramazan parashikohet të jetë Dita e Bedrit.
8. Më 16. Mars 2026, dita e Hënë ose më 26 Ramazan parashikohet të jetë Nata e Lejl. Kadrit.
9. Më 20. Mars 2026, dita e Premte do të bëhet falja e Fitër Bajramit në ora 07:30 në lokalim e QIKSHN-së në Sverres gate 8, 0652 OSLO.

Nëse keni ndonjë propozim apo ndonjë ide gjatë muajt Ramazan ju lutemi mos nguroni të na kontaktoni në tel.: 22 35 33 72 ose na shkruani në e-post adresën adm@qiksh.no.

Jemi të gatshëm që së bashku të japim angazhimin për gjëra që janë në dobinë e të gjithëve.

QIKSHN ju dëshiron agjërimit të pranuar, iftar të këndshëm, adhurim dhe devotshmëri gjatë këtij muaji të bekuar.

Me respekt
Qendra Islamike Kulturore Shqiptare në Norvegji
Kryesia e QIKSHN'së

Adresse:
Sverres gate 8
0652 OSLO

Org. nr.:
9756 11 515

Telefon:
+47 22353372

Web:
qiksh.no

E-post:
adm@qiksh.no



QENDRA ISLAMIKE KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI
ALBANSK ISLAMSK KULTURSENTER I NORGE
ALBANIAN ISLAMIC CULTURAL CENTER IN NORWAY

Informim – Ramazani 1477H/2026

Es-selamu Alejkum we rahmetull-llahi we berekatuhu. Paqa dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ju. Ju informojmë se muaji agjërimit “Ramazani” (sipas parashikimeve të Muslimsk Dialognettverk i Norge - MDN) fillon me datë 19.02.2026 (E Enjte) dhe mbaron me datën 19.03.2026 (E Enjte)*

Dita e festës së Fitër Bajramit parashihet të jetë më datë 20.03.2026 (E Premte). Namazi i Fitër Bajramit do të falet në ora 07:30 min.

*Këto të dhëna janë sipas parashikimeve të Muslimsk Dialognettverk i Norge - MDN. Për çdo ndryshim që mund të ndodhë do të njoftoheni, nëpërmjet faqës elektronike www.qiksh.no dhe facebook.com/qikshn. Ju lutemi na vizitoni!

SADAKATUL FITRI (KONTO 1503 25 27733 ose VIPPS #653934)

Agjërimi i Ramazanit është i ndërlidhur me dhënien e sadakatul-fitrit. *“I Dërguari i Allahut e obligoi Sadakatul-Fitrin për çdo të madhë dhe të vogël prej muslimanëve”*

Dhënia e sadakatul-fitrit është vaxhib. Besimtari është i obliguar ta jep atë për vehte dhe për ata për të cilët kujdeset (fëmijët, bashkëshorten, prindërit, shërbëtorin e të tjerë).

Koha e dhënies së sadakatul-fitrit: është që nga dita e parë e Ramazanit e deri para faljes së namazit të Bajramit. Megjithatë, koha më e preferuar është gjatë dhjetë ditëve të fundit të këtij muaji dhe gjatë ditëve tek (dita 21, 23, 25, 27, 29), dhe sidomos e preferuar është dita e 27, Nata e Kadrit. Sasia e sadakatul-fitrit, është caktuar dhe vendosur që të jetë sipas këtyre kategorive: kategoria e parë kr. 200,- kategori e dytë kr. 150,- dhe kategoria e tretë kr. 100,- për person.

Pagesa mund të bëhet nëpërmjet xhiros **15032527733** ose **Vipps #10532 dhe zgjith kategorin Fitra 2026** apo drejtpërdrejt në lokalet e qendrës në Oslo. Shuma e pagesës llogaritet sipas numrit të anëtarëve në familje.

ZEKATI (KONTO 1503 25 27725 ose VIPPS #653935)

Çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, që në fund të vitit ka vlerë të hollash në mbi tetëdhjetë e pesë (85) gramë ari, të gatshme apo në formë artikujsh tregtarë, duhet të japë zeqatë me një sasi minimale prej 2.5 për qind nga ajo pasuri. Shembull: *(2,5% prej kr. 10 000 NOK= 250 NOK)*.

Koha e dhënies së Zekatit: është i tërë viti, por pasiqë muaji Ramazanit është muaji më i vlefshëm i tërë vitit, atëherë mirë është që të jepet gjatë këtij muaji. Zekati është farz dhe shtyllë e Islamit, kush nuk e jep ka mëkat të madh.

Pagesa mund të bëhet nëpërmjet xhiros **15032527725** ose **Vipps #10532 dhe zgjidh kategorin Zeqat 2026** apo drejtpërdrejt në lokalet e qendrës në Oslo.

Kujt i takon Zekati dhe Sadakatul-Fitri?

Sikurse zekati dhe lëmoshat tjera, po ashtu edhe sadakatul-fitri u jepet fondeve të përmendura në ajetin që vijon.

All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zeqati etj.) t’ju takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve atyre që duhet përfituar zemrat (të dobëtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet. (Et Tevbeh, 60).

Pagesa mund të bëhet nëpërmjet xhiros apo drejtpërdrejt në lokalet e qendrës në Oslo. Për çdo aktivitet gjatë këtij muaji dhe çdo lloj ndryshimi ju lutemi vizitoni webfaqen www.qiksh.no ose kontaktoni në numrin e telefonit 22 35 33 72.

Zoti ua pranofte agjërimin, zekatin dhe sadakatul-fitrin!

Adresse:
Sverres gate 8
0652 OSLO

Org. nr.:
9756 11 515

Telefon:
+47 22353372

Web:
qiksh.no

E-post:
adm@qiksh.no